



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:089801
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05829714
Ac.nr.320/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.D. nga fsh....., K. P.....të cilën e përfaqëson i autorizuari av.Blerim Ademaj nga Peja, kundër të paditurës Komuna e Pejës të cilën e përfaqëson av.Drita Sopi Gashi, me bazë juridike kompensim i dëmit, vlera e kontestit 9,294 euro, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.1148/16, i datës 07.12.2020, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e të autorizuarit të paditëses: H.D. nga fsh....., P....., PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.1148/16, i datës 07.12.2020 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1148/16, i datës 07.12.2020, ka vendosur si në vijim:

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses H.D. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Pejës që ti kompensojë paditëses H.D. për dëmin e shkaktuar shumë prej 3200 euro në emër të vlerës reale të pronës së afektuar ngastrën 72/1 ZK Ll.....dhe për 5 vite në emër të fitimit të humbur të shumë prej 6094 euro, në total prej 9247 euro, si e pabazuar.

II. Secila nga palët i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e paditëses në tërësi si të bazuar ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja: H.D. nga fsh....., P....., përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit material, ndërsa me datën 29.10.2020 në gjykatë ka dorëzuar parashtresë për precizim të kërkesëpadi në përputhje me ekspertin e bujqësisë, duke kërkuar që të aprovohet sie bazuar padia dhe kërkesëpadi e paditëses, ashtu që të obligohet e paditura që ti kompensojë shumën prej 9247 euro në emër të vlerës reale të pronës së afektuar dhe fitimin e munguar në ngastrën 72/1 ZK Llabjan, me kamatë dhe me pagesë të shpenzimeve të procedurës aq sa krijohen.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr. 1148/16 i datës 07.12.2020, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Me provat e administruara është jokontestuese fakti se paditësja është pronare e ngastrës kadastrale P-71611051-00072-1 me sipërfaqe prej 5788 m² në ZK Ll....., ngastër kjo e cila shfrytëzohet si parcelë bujqësore me pjesë të pronës 1/1.

Gjykata gjatë identifikimit të ngastrës kadastrale me datën 01.04.2019 së bashku me ekspertin gjeodet F.H.dhe nga ekspertiza e punuar nga i njëjti ekspert është vërtetuar se parcela kadastrale me numër të njësisë 72/1 me kulturë arrë klasa e tretë në sipërfaqe prej 5788 m² evidentohet në emër të H.D, ngastër kjo e cila në anën perëndimore kufizohet me ngastrën 67 pronë shoqërore, në anën jugore kufizohet me ngastrën nr.72/2, në anën lindore me ngastrën 251/1, në anën veri lindore dhe veriore kufizohet me ngastrën 71 dhe 70.Kanali i cili shtrihet në anën juglindore të ngastrës nr.72/1 drejtimin veri jug ka sipërfaqe prej 20 m². Nga kopja e planit me numër kadastral nr.2 dhe skica e matjes e punuar me datë 01.04.2019 të cilat i janë bashkangjitur ekspertizës konstatohet se kanali është i paraqitur me ngjyrë të kaltër ndërsa ura e ndërtuar mbi kanal është e vijëzuar me ngjyrë të kuqe, ndërsa nga ortofoto e cila i është bashkangjitur ekspertizës konstatohet ngastra kadastrale numër 72-1 e vijëzuar me ngjyrë të verdhë e kufizuar me parcelat e lartcekura. Ekspertit të bujqësisë B.K.në ekspertizën e tij dhe plotësimin e datës 13.12.2019 ka konkluduar se mbi vlerësimin e vlerës reale të ngastrës kontestuese në çmimin qarkullues në treg dhe fitimin e humbur për ngastrën kadastrale nr.72/1 me sipërfaqe prej 5788 m² ZK Ll....., K. P.....në pronësi të H.D, ka theksuar se çmimi i tregut në këtë sipërfaqe sillet prej 1000-3000 euro për ari, ndërsa në rastin konkret i njëjti ka jap mendim se humbjet në pleshmërinë e ngastrës dhe kostot e shpenzimit për vitin 2014 është 1219 euro për një (1)vit duke llogaritur nëse në këtë tokë do të mbjellin lakra ndërsa për pesë(5) vite 6094 euro, ashtu që ky çmim mund të ndryshojë prej vitit në vit dhe atë varësisht nga pozita, infrastruktura dhe interesi. Nga provat e administruara pala paditëse me asnjë provë[nuk e ka vërtetuar bazueshmërinë e kërkesëpadi, si për fitimin e humbur ashtu edhe për zvogëlimin e vlerës së pleshmërisë së pronës së paditëses, përkundrazi paditësja ka deklaruar se këtë tokë nuk e ka punuar asnjëherë, por këtë e kanë punuar anëtarët e saj të familjes. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se sa i përket fitimit të humbur paditëses i mungon legjitimiteti real aktiv për të qenë palë në këtë çështje kontestimore.

Tutje gjykata ka shtuar se sa i përket zvogëlimit të vlerës së tokës bujqësore pala paditëse me asnjë provë nuk ka vërtetuar se me ndërtimin e kanalit të ujitjes së kësaj toke i 'u ka zvogëluar vlera, gjithashtu pala paditëses është paqartë me kërkesën e saj sepse në njërin anë kërkon kompensim dëmi në lidhje me zvogëlimin e vlerës së tokës e në anën tjetër thirret në shpronësim të tokës bujqësore gjë që nga provat e administruara me asnjë provë[nuk është vërtetuar se është bërë shpronësimi i kësaj toke, përkundrazi paditësja asnjëherë nuk ka bërë kërkesë në procedurë administrative për shpronësimin e kësaj paluajtshmërisë. Pala paditëse deri në përfundim të seancës së shqyrtimit kryesor thirret në zvogëlimin e vlerës së tokës e në anën tjetër kërkon shpronësimin e kësaj pjese të tokës të cilën pretendon se nuk mund të e shfrytëzojë, e në të njëjtën kohë edhe kërkon shpërblimin e dëmit material konform dispozitave të nenit 169 të LMD-së ,por me provat e administruara nuk është vërtetuar se e paditura i ka shkaktuar dëm material paditëses. Zvogëlimi i pasurisë(dëmi real)sipas nenit 137 të LMD-së nënkupton zvogëlimin e pasurisë aktive që përfaqëson dëm natyror. Dëmi natyror është[ndryshim ndërmjet gjendjes reale dhe gjendjes që do të ishte sikur të mos paraqitej rasti dëmtues, nëse kjo gjendje e mëvonshme sikur të mos paraqitej rasti do të ishte më e mirë. Kështu kusht është që të paraqitet ky ndryshim ndërmjet gjendjes reale ekzistueses dhe asaj pa paraqitjen e rastit dëmtues i cili edhe do të përbënte dëm.Shikuar nga aspekti juridik dëmi natyror duhet të jetë dëm i pranuar nga e drejta dhe sistemi juridik, që do të thotë se cenimi i pasurisë paraqet edhe cenimin e të drejtës përkatësisht të interesave të mbrojtura juridike. Sa i përket fitimit të humbur për dallim nga zvogëlimi i pasurisë që paraqet dëmin real nënkupton fitimin evident në të ardhmen, të cilin do ta realizonte i dëmtuar sikur të mos paraqitej rasti dëmtues. Ndërsa sa i përket fitimit të humbur gjykata nuk ka mund që ta aprovojë këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditëses pasi që e njëjta ka deklaruar se asnjëherë tokën e saj bujqësore nuk e ka punuar por këtë e kanë bërë anëtarët e tjerë të familjes, e që në rastin konkret paditëses i mungon legjitimiteti real aktiv për të kërkuar fitimin e humbur .

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar nenit 7 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, nenit 169 dhe 137 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përrshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve

të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve për arsye se në këtë rast gjykata është pse ka caktuar ekspertim nga lëmia përkatëse - ekspertin nga lëmia e gjeodezisë, për identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmërisë kontestuese dhe konstatimin e gjendjes faktike në vend e njëjta është e pa qartë, pasi që edhe përkundër faktit se gjykata ka dalë në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale, në të cilën paditësja ka pretenduar se i padituri i ka shkaktuar dëmin material siç ka pretenduar me padi, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësja, të identifikojë saktësisht se cila është parcela kadastrale apo pjesë e saj, në të cilën paditësja ka pretenduar se iu është shkaktuar dëmi përkatësisht i është uzurpuar prona, duke u përshkruar saktësisht shtrirja gjeografike e saj, gjerësia dhe gjatësia e saktë dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me atë parcelë kadastrale, se paluajtshmëria kontestuese a ka qenë objekt i shpronësimit, nëse po kur dhe nga kush është shpronësuar, pasi që në shkresat e lëndës nuk kemi vendim sa i përket shpronësimit e as shkresat e lëndës që i referohen shpronësimit, pastaj me ekspertizën e gjeodete nuk është konstatuar saktë se sa ka qenë sipërfaqeje që pretendohet se i është marr paditëses për ndërtimin e kanalit, pastaj përmes kësaj ekspertize nuk është konstatuar se a ka të ndërtuar urë lidhëse mbi kanal në mes të parcelës së paditëses, pra paditësja a ka mundur ta shfrytëzoj pjesën tjetër të parcelës që nuk është uzurpuar (pra gjykata ka dështuar të vërtetoj dy fakte me rëndësi përmes ekspertizës së gjeodezisë dhe atë sa është sipërfaqe që pretendohet se i është marr paditëses për ndërtimin e kanalit si dhe a ka pasur të nderuar urë në mënyrë që pjesën tjetër të pronës paditësja ta shfrytëzoj pa pengesa). Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes me rastin e daljes në vend për identifikimin e paluajtshmërisë kontestuese dhe konstatimin e gjendjes faktike në vend është dashur që marrjen e provës me shikim të drejtpërdrejt ta bëjë në bashkëveprim me ekspertin gjeodet dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë. Po ashtu edhe pse në këtë rast gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë ka nxjerr provën me ekspertim për vlerësimin real të ngastrës kontestuese, dhe fitimin e humbur, për të cilën shumë paditësja ka kërkuar kompensimin, mirëpo në këtë rast mendimi i ekspertit i dhënë në ekspertizë është i mangët dhe jo i plotë, pasi që në ekspertizën e ekspertit të bujqësisë është theksuar llogaritja e përgjithësuar për tërë sipërfaqen pa e bere ndarjen e sipërfaqes që pretendohet se i është marr për ndërtimin e kanalit, po ashtu për llogaritja e fitimit të humbur ka mbutuar e pa sqaruar. Po ashtu në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka ftuar ekspertin e bujqësisë për të dhënë sqarime lidhur me mendimin e dhënë, (meqenëse ky ekspert nga gjykata e shkallës së parë është konstatuar se ka vdekur, është dashur të nxjerrjet ekspertizë për vlerësim nga ekspert tjetër) ku si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të nenit 362 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se: “Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes”.

Si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për të cilën gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i atakuar u dashtë që të prishet dhe të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, të caktoj shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, ta caktoj nxjerrjen e provës me ekspertim nga lëmia e gjeodezisë, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre si dhe ekspertin gjeodet të dalë në vend, ashtu që gjykata sipas

përshkrimin të cilin do ta bëjë paditësi rreth paluajtshmërisë që pretendon se iu është shkaktuar dëmi, të udhëzoj ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmërisë kontestuese, të përcaktohet saktë se sa është sipërfaqja që pretendohet se i është marr paditëses për ndërtimin e kanalit, të konstatohet fakti se paditësja a ka pasur qasje në pjesën tjetër të parcelës në të cilën nuk është ndërtuar kanali, dhe pas kësaj gjykata të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike, nëpërmes dëgjimit të palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës, të caktoj ekspertizë me angazhimin e ekspertit vlerësues të pronës së paluajtshme, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. Me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si me lart nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Gjykata shkallës së parë në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 320/2021, me datë 11.06.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v